



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KESHILLI

Nr. 2345 / 9 prot.

Pogradec, më 26 / 06 2025

VENDIM

Nr. 60, DATË 25 / 06 /2025

PËR MIRATIMIN E LISTËS TË SIPËRFAQES SË TOKËS PREJ 2,7356 HA, E NDODHUR NË NJËSINË ADMINISTRATIVE ÇËRRAVË QË MUND TË JEPEN ME QIRA.

Në mbështetje të nenit 54 të ligjit nr. 139/2015 "Per Vetëqeverisjen Vendore", neni 2 i ligjit nr. 8312, datë 26.03.1998 "Për tokat bujqësore të pandara", Udhëzimin nr. 1, datë 18.07.2012, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara" dhe Udhëzimit nr.2, datë 20.04.2016 "Për shfuqëzimin e udhëzimit nr. 3, datë 27.11.2013, të Këshillit të Ministrave "Për pezullimin e përkohshëm të udhëzimit nr.1, datë 18.07.2012, të Këshillit të Ministrave "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara" me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë listën e sipërfaqes së tokës bujqësore prej 2 Ha (dy) dhe 7356 m² (shtatë mijë e treqind e pesëdhjetë e gjashtë), të ndodhur në Njësine Administrative Çërravë, që mund të jepen me qera sipas listës.

Nr	Pronësi a	Z K	Nr Pasurisë	Vol	Faq e	Vëndodhja	Sip m2	Lloji
1	Shtet	3047	9	2	26	Pretushë, Çërravë	27356	Pemtore
						TOTALI	27356	

2. Toka Bujqësore që do të jepet me qera do të shfrytëzohet vetëm për veprimtari bujqësore dhe të tjera veprimtari në funksion të saj.
3. Afati i dhënies me qera do të jetë në përputhje me destinacionin e kultivimit por asnjëherë më i gjatë se afati i përcaktuar pikën IV të Udhëzimit nr. 1, datë: 18.07.2012, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat e dhënies me qera të tokave bujqësore të pandara".
4. Çmimi dysheme i vlerës së qerasë nuk do të jete jo më pak se 6000 (gjashtë mijë) lekë Ha në vit sipas pikës nr 10 të Udhëzimit nr. 1, datë: 18.07.2012, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat e dhënies me qera të tokave bujqësore të pandara".
5. Për zbatimin e vendimit ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Drejtori e Burimeve

¹Bulevardi "Rreshit Çollaku", Lagja: Nr.2, Tel: +355 (83) 222222, Fax: +355 (83) 222441, E-mail: bashkiapogradec@gmail.com



Njerezore dhe Çështjeve Juridike, si dhe Njësia Administrative Çërravë.
6.Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë nga data e shpalljes.

KRYETARE E KËSHILLIT

Manjola KAMOLLI



1.Miratuar me 20 vota

2.Vota Pro 20

3.Vota Kundër 0

4.Vota Abstenim 0

5.Zbardhur më date 26.06.2025